

Statuti i Akademisë Austriake të Shkencave

Vjenë, qershor 2016

Versioni i ri i statutit të vendosur në Asamblenë e Përgjithshme të Akademisë më 11 mars 2016 u konfirmua me anë të një vendimi të Kryetarit Federal Dr. Heinz Fischer më 25 maj 2016 S400020 / 1-BEV / 2016. Akademia Austriake e Shkencave u informua për këtë konfirmim nëpërmjet Ministrisë Federale të Shkencës dhe Ekonomisë më 24 qershor 2016.

Ky tekst është menduar thjesht si një mjet dokumentimi. Në të gjitha rastet, versioni gjerman do të jetë ligjërish i detyrueshëm.

STATUTI

i Akademisë Austriake të Shkencave

Neni 1

"Akademia Perandorake e Shkencave", e themeluar nga Perandori Ferdinand I në bazë të statutit të datës 14 maj 1847, mban emrin "Akademia Austriake e Shkencave" që nga 1 korrik 1947. Ajo promovon të gjitha aspektet e shkencës, veçanërisht nëpërmjet hulumtimit të pavarur të anëtarëve dhe njësive të saj.

Neni 2

(1) Akademia Austriake e Shkencave, që do të referohet në vijim si Akademia, është një entitet publik ligjor, që gëzon mbrojtje të veçantë nga qeveria federale. Ajo do të mbetet e pavarur nga autoritetet federale dhe shtetërore në fushën e veprimtarisë së saj, siç përcaktohet nga ky Statut, përveçse nëse ky statut parashikon përjashtime.

(2) Për të përmbushur detyrat e saj, Akademia ka të drejtë të kryejë të gjitha llojet e transaksioneve ligjore dhe të përdorë pasuritë e saj në mënyrë të përshtatshme.

(3) Akademia themelon dhe drejton njësi kërkimore dhe një shtëpi botuese. Strukturat organizative përkatëse rregullohen nga aktet nënligjore.

(4) Akademia komenton për çështje shkencore relevante. Ajo mund të sigurojë raportime shkencore për autoritetet federale, autoritetet shtetërore ose persona të tjerë juridikë.

(5) Për të përmbushur detyrat e saj statutore, Akademia mund të krijojë dhe menaxhojë fondacione dhe të pranojë çdo angazhim ose mjete. Ajo mban marrëdhënie me institucionet që shërbejnë për qëllime shkencore ose për qëllime të tjera kulturore dhe mund të caktojë përfaqësues të saj tek këto institucione. Në veçanti, ajo mund të kontaktojë akademi të tjera,

organizata sponsorizuese dhe kompani shkencore në mënyrë që të kryejë angazhimet e veta ose angazhime të jashtme.

(6) Akademia jep bursa dhe shpërblime për arritjet shkencore.

(7) Akademia përpilon rregullisht raporte për aktivitetet e saj.

Neni 3

Sfera e veprimtarisë së Akademisë mbulon të gjitha shkencat. Akademia siguron respektimin e rregullave ndërkombëtare të praktikave të duhura shkencore, ka nënshkruar Kartën Evropiane për studiuesit, dhe siguron trajtim të barabartë mes burrave dhe grave brenda sferës së vet të aktivitetit.

Neni 4

(1) Akademia përbëhet nga dy degë – Dega e matematikës dhe shkencave natyrore dhe dega e Shkencave Humane dhe shkencave sociale - si dhe Akademinë e të Rinjve. Çdo degë dhe Akademia e të Rinjve kanë sferën e tyre të veprimtarisë në çështjet shkencore; detyrat administrative ndiqen nga Akademia në tërësi.

(2) Asambleja e Përgjithshme është organi suprem për mbikëqyrje konsulencë dhe vendimmarrje të Akademisë, në të cilën të dyja degët dhe Akademia e të Rinjve punojnë së bashku për të përmbushur detyrat e Akademisë si një e tërë.

(3) Asambleja e Përgjithshme përcakton aktet nënligjore në bazë të këtij Statuti.

Neni 5

(1) Takimet e Degëve, Asambleja e Përgjithshme dhe Takimet e Akademisë së të Rinjve mbahen rregullisht. Takimet e jashtëzakonshme mund të thirren në raste të rëndësishme.

(2) Çdo vit mbahet një sesion ceremonial, në të cilën publikut I jepet një pasqyrë e aktiviteteve të Akademisë dhe zhvillimet në Akademi. Në këtë seancë do të ftohen të gjithë anëtarët.

Neni 6

(1) Akademia përfshin (jo më shumë se):

(a) 90 anëtarë të rregullt në Austri; 45 në çdo degë;

(b) 250 anëtarë korrespondentë, 125 në secilën degë, nga të cilët 55 janë në Austri dhe 70 jashtë vendit;

(c) 24 anëtarë nderi, nga të cilët 6 janë anëtarë të Akademisë në tërësi dhe 9 janë anëtarë të çdo dege;

(d) 70 anëtarë të Akademisë së Rinj të zgjedhur për një periudhë të caktuar.

(2) Anëtarët e rregullt dhe korrespondentë mbi 70 vjeç nuk përfshihen në shifrat maksimale, ndërsa të drejtat e tyre janë plotësisht të ruajtura.

(3) Në zgjedhjen e anëtarëve duhet të merret parasysh një zgjedhje e barabartë e disiplinave.

(4) Anëtarët e rregullt zgjedhin anëtarët e rregullt të Akademisë, anëtarët korrespondentë si dhe anëtarët e nderit.

(5) Anëtarët e Akademisë së të Rinjve zgjidhen nga Akademia e të Rinjve; zgjedhjet duhet të konfirmohen sipas Nenit 7 paragrafi 5.

(6) Duke pranuar zgjedhjen e tyre, të gjithë anëtarët angazhohen të avancojnë objektivat e Akademisë dhe të marrin pjesë në detyrat e saj.

(7) Akademia mund të japë tituj nderi dhe shpërblime për personat në njohje të shërbimeve të tyre në Akademi.

Neni 7

(1) Anëtarët zgjidhen në përputhje me rregullat e zgjedhjeve të përcaktuara në bazë të akteve nënligjore. Lejohen sistemet elektronike të votimit. Duke pranuar zgjedhjen e tyre, kandidatët e zgjedhur fitojnë të drejtat dhe detyrat e anëtarësisë.

(2) Anëtarët e rregullt, si dhe ata anëtarë korrespondentë të cilët janë zgjedhur në përputhje me aktet nënligjore, mund të marrë pjesë dhe për të votuar në të gjitha takimet e mbajtura nga dega e tyre dhe nga Akademia si një e tërë.

(3) Përfaqësuesit e Akademisë së të Rinjve, të cilët janë zgjedhur në përputhje me aktet nënligjore, kanë të drejtë në mënyrë të ngjashme për të marrë pjesë dhe për të votuar në të gjitha takimet e mbajtura nga Akademia si një e tërë, si dhe takime dege sipas përcaktimeve në aktet nënligjore

(4) Të gjithë anëtarët që kanë të drejtë vote duhet të ftohen në Asamblenë e Përgjithshme në të cilën merren vendime për ndryshimin e statutit ose akteve nënligjore. Ftesat duhet të bëhen me shkrim dhe duhet të përcaktojnë pikat e rendit të ditës.

(5) Në mbledhjet zgjedhore në të cilat zgjedhen anëtarët e rregullt dhe korrespondentë dhe konfirmohet zgjedhja e anëtarëve të Akademisë së të Rinjve ftohen vetëm anëtarët e rregullt.

(6) Anëtarët e Akademisë së të Rinjve ftohen në mbledhjet e zgjedhjeve të Akademisë së të Rinjve.

Neni 8

(1) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut, vendimet merren me shumicë absolute të votave të vlefshme. Lejohen rezoluta me votim elektronik dhe qarkullues. Nga kjo përjashtohen vendimet lidhur me statutin ose aktet nënligjore të Akademisë.

(2) Numri i anëtarëve që kërkohet të marrin pjesë në mbledhje në mënyrë që zgjedhjet / vendimet të jenë të vlefshme, do të përcaktohen në statute, përveçse nëse parashihet ndryshe në këtë Statut.

Neni 9

(1) Ndryshimet në statut kërkojnë shumicën prej dy të tretave të votave të vlefshme të realizuara në prani të dy të tretave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të rregullt të përcaktuar në Nenin 6 paragrafi. 1a i Statutit. Këto ndryshime duhet të konfirmohen nga Presidenti Federal.

(2) Vendimet mbi aktet nënligjore mund të bëhen vetëm nëse janë të pranishëm dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të rregullt të përcaktuar në Nenin 6 paragrafi 1 të statutit.

Neni 10

(1) Komiteti Drejtues është bordi drejtues i Akademisë dhe organi ekzekutiv suprem. Ky Komitet është veçanërisht përgjegjës për kryerjen e punës dhe organizimin e administratës. Komiteti Drejtues përbëhet nga një Kryetar, një Nënkyetar dhe një sekretar nga çdo degë. Hollësi të mëtejshme, në veçanti lidhur me përfaqësimin e jashtëm, janë të përcaktuara në aktet nënligjore.

(2) Sekretari i një dege vepron si kryetar i degës së tij / saj.

(3) Anëtarët e Komitetit Drejtues zgjidhen për pesë vjet dhe marrin shpërblimin e përcaktuar për punën e tyre.

(4) Anëtarët e Komitetit Drejtues zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme nga radhët e anëtarëve të rregullt në përputhje me rregullat e zgjedhjeve të përcaktuara me akt nënligjor. Kryetari dhe nënkryetari, si dhe të dy kryetarët e degëve, duhet t'i përkasin degëve të ndryshme. Zgjedhja e Kryesisë është subjekt i pranimi të tyre. Anëtarët e Komitetit Drejtues mund të rizgjidhen në pozicionin e tyre një herë.

(5) Anëtarët e Komitetit Drejtues të zgjedhur duhet të konfirmohen nga Presidenti Federal.

Neni 11

(1) Asambleja e Përgjithshme përcakton një Këshilli të Akademsë të përbërë nga gjashtëmbëdhjetë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, katër prej të cilëve nuk janë anëtarë të Akademisë.

(2) Këshilli i Akademisë duhet të mbikëqyrë menaxhimin e Akademisë. Detyrat e menaxhimit nuk mund t'i caktohen Këshillit të Akademisë. Megjithatë, disa përgjegjësi të rëndësishme të përcaktuara në aktet nënligjore mund të kryhen vetëm me pëlqimin e Këshillit Akademik.

(3) Brenda Këshillit Akademisë ngrihet një komitet i auditimit, dhe është veçanërisht përgjegjës për monitorimin e procesit të kontabilitetit, sistemin e brendshëm të auditimit, auditimin e llogarisë vjetore dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

(4) Aktet nënligjore rregullojnë detaje të mëtejshme të detyrave dhe përgjegjësive të Akademisë, strukturën e saj të brendshme dhe agjendat e tjera përkatëse.

Neni 12

(1) Një Senat ndihmon Akademinë me çështje themelore.

(2) Senati përbëhet nga nëntë anëtarë. Anëtarët e Senatit mund të jenë persona nga shkencat, shoqëria, ekonomia apo politika që kanë lidhje me shkencat. Këta persona janë të pavarur dhe nuk përfaqësojnë institucionet në të cilat ata janë të punësuar. Senati duhet të përfshijë gjithmonë:

(a) Kryetarin e Këshillit Kombëtar si kryetar;

(b) një përfaqësues të Konferencës së Guvernatorëve të Shtetit Austriak;

(c) Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Austrisë;

(d) Presidenten e Bibliotekës Kombëtare Austriake;

(e) një përfaqësues të Këshillit Austriak për Kërkimin dhe Zhvillimin e Teknologjisë;

(f) një përfaqësues të Bordit Austriak të Shkencës;

(3) Anëtarët e tjerë zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me votim të fshehtë. Rizgjedhja lejohet. Komiteti Drejtues ka të drejtë të propozojë kandidatë.

(4) Anëtarët e Senatit të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme mbeten në detyrë për një periudhë pesëvjeçare.

(5) Senati i Akademisë ka këto detyra:

a) Nxitjen e aktivitetit publik të Akademisë;

b) paraqitjen e çështjeve me interes publik për Akademinë;

c) këshillimin e Akademisë për çështje të tjera thelbësore për përmbushjen e detyrave të tij ligjore;

d) pranimin e raportit të Kryetarit të Akademisë për vitin e mëparshëm punues;

e) Përcaktimin e shpërblimit të anëtarëve të Komitetit Drejtues.

(6) Vendimet e Senatit bëhen me shumicën absolute të votave të vlefshme të hedhura në pranimë e më shumë se gjysmës së të gjithë senatorëve. Nëse votat janë ndarë barabartë, kryetari ka votën përcaktuese. Vendimet e Senatit duhet t'i raportohen Asamblesë së Përgjithshme.

(7) As anëtarët e nderit, anëtarët e rregullt ose korrespondentë, anëtarët e Akademisë së të Rinjve, as personat e punësuar në Akademi nuk mund të jenë anëtarë të Senatit. Nëse mandati refuzohet ose ka arsye për përjashtim ose konflikt interesi, Asambleja e Përgjithshme, sipas kërkesës së Senatit, duhet të gjejë një zëvendësim për të plotësuar postin.

(8) Anëtarët e Senatit marrin personalisht pozicionin e tyre. Senati mblidhet të paktën një herë në vit dhe gjithashtu mund të marrë vendimet në format qarkullues.

(9) Senati përcakton rregullat e veta procedurale, të cilat duhet të këshillohen me Komitetin Drejtues dhe Asamblesë së Përgjithshme.

(10) Puna e kryer nga anëtarët e Senatit është vullnetare. Rimbursimi i kostove për udhëtim ose akomodim për shkak dhe gjatë kryerjes së këtyre detyrave bëhet sipas rregullave ligjore në fuqi. Detaje të mëtejshme përcaktohen në aktet nënligjore të Senatit.

Neni 13

(1) Një Bord I Kërkimit ndihmon Akademinë në sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm dhe cilësisë së kërkimit të kryer në Akademi.

(2) Bordi përbëhet nga shkencëtarë të njohur ndërkombëtarisht që punojnë jashtë vendit, të cilët zgjidhen për pesë vjet nga Asambleja e Përgjithshme. As anëtarët e nderit, anëtarët e rregullt ose korrespondentë në Austri, anëtarët e Akademisë së të Rinjve, as personat e punësuar në Akademi nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Kërkimit. Nëse mandati refuzohet ose nëse lindin arsye për përjashtim ose konflikt interesi, Asambleja e Përgjithshme duhet të gjejë një zëvendësim për të plotësuar pozicionin. Anëtarët mund të rizgjidhen një herë.

(3) Në veçanti, detyrat e Bordit të Kërkimit përfshijnë:

a) i bën rekomandime Komitetit Drejtues dhe Asamblesë së Përgjithshme për programin afatmesëm të kërkimit të Akademisë, duke marrë parasysh zhvillimet në shkencë;

b) përcakton parimet e përgjithshme të kontrollit të cilësisë në konsultim me Komitetin Drejtues, veçanërisht për themelimin, zhvillimin, ri-fokusimin, ristrukturimin ose mbylljen e ndonjë prej njësive kërkimore të Akademisë;

c) ngre grupe vlerësimi për të vlerësuar të reja shkencore dhe për të vlerësuar njësitë kërkimore ekzistuese;

d) bën rekomandime për Komitetin Drejtues dhe Asamblesën e Përgjithshme në lidhje me zbatimin e rezultateve të vlerësimit.

(4) Detaje të mëtejshme rregullohen në aktet nënligjore.

Neni 14

(1) Gjatë çdo periudhe buxhetore, Akademia merr një buxhet të plotë për të përfunduar detyrat ose aktivitetet e tij të dakorduara me qeverinë federale. Ky buxhet përcaktohet nga qeveria federale në bazë të kërkesës ose si pjesë e marrëveshjeve të performancës. Nëse këto fonde nuk janë shfrytëzuar plotësisht deri në fund të një periudhe buxhetore, pjesa e mbetur mbetet në dispozicion të Akademisë dhe bartet në periudhën e ardhshme. Kjo nuk justifikon një reduktim të pagesave monetare të qeverisë federale.

(2) Të ardhurat e tjera të fituara mbahen nga Akademia dhe nuk e zvogëlojnë buxhetin e përgjithshëm të përmendur në paragrafin 1.

(3) Akademia përpilon çdo vit një raport mbi përdorimin e fondeve të akorduara nga qeveria federale. Ky raport duhet t'i dorëzohet për shqyrtim Gjykatës së Auditimit të Austrisë.

(4) Detaje të mëtejshme rregullohen në aktet nënligjore.

Neni 15

Akademisë I jepet ndërtesa në pronësi federale e vendosur në adresën Dr. Ignaz Seipel-Platz 2, 1010 Vjenë, dorëzuar me anë të një vendimi imperial në 1857, për përdorimin e plotë të saj. Qeveria federale paguan çdo shpenzim për mirëmbajtjen e pronës.

Neni 16

Dispozitat e përkohshme:

(1) Neni 10 paragrafi 3 i këtij Statuti hyn në fuqi vetëm me fillimin e mandatit të ri të Komitetit Drejtues, pas hyrjes në fuqi të këtij statuti. Deri në atë kohë, aplikohet Neni 10 paragrafi 3 i Statutit në versionin e datës 17 dhjetor 2010.

(2) Neni 11 paragrafi 1 i këtij Statuti hyn në fuqi vetëm me zgjedhjen e radhës të Këshillit të Akademisë, që duhet të jetë brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij Statuti. Deri në atë kohë aplikohet Neni 11 paragrafi 1 i Statutit në versionin e datës 17 dhjetor 2010.